



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

TË DHËNA MBI VENDIMIN Nr. 74, Datë 03.11.2023

MONITORIM I KYER NGA APP

Autoriteti kontraktor	AKADEMIA E FORCAVE TË ARMATOSURA
Hetim Administrativ, iniciuar nga	• APP X • Reklamim nga të tretë
Numri i kontratave	1 (një)
Konstatimet kryesore	Gjatë hetimit administrativ, APP konstatoi se: 1. Plani i zbatimit të kontratës ka mangësi përse i përket përfshirjes së çështjeve organizative, afateve dhe çështjeve teknike të kontratës, që lidhen me monitorimin e zbatimit të saj. Gjithashtu, plani i zbatimit të kontratës duhet të hartohet në çdo rast nga personat përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të kontratës, të cilët duhet të ngarkohen nga Titullari në urdhrin/dokumentin përkatës. 2. Autoriteti Kontraktor nuk ka vepruar në përputhje me pikën 1, të nenit 124, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, si dhe pikës 7, të nenit 107, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, pasi për kontratën objekt hetimi, nuk ka administruar gjatë zbatimit të kontratës gjithë dokumentacionin e nevojshëm, si dhe nuk ka kryer verifikimet përkatëse, për të siguruar që malli i dorëzuar i plotëson kërkesat e cilësisë, në përputhje me kushtet e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe në kontratë.
Masat e marra	Në bazë të neneve 23, gërma “e”, dhe 132, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, APP vendosi të propozojë dhënien e masës disiplinore ndaj 4 personave, në cilësinë e anëtarëve të komisionit të marrjes në dorëzim të mallit dhe personit përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të kontratës, përgjegjës për shkeljet dhe mangësitë e konstatuara në vendim.